

**20222854298**

Në bazë të nenit 71 paragrafi (9) të Ligjit për lëndët e para minerale (\*) ("Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë" nr. 136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16, 120/16, 189/16, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 99/22), ministri i Ekonomisë miratoi

## **RREGULLORE PËR MËNYRËN E PUNËS SË KOMISIONIT PËR USHTRIMIN E VLERËSIMIT (REVIZIONIT) PROFESIONAL TË PROJEKTEVE MINERARE**

### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Komisionit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të projekteve minerare.

### Neni 2

Komisioni për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të projekteve minerare (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) punon në seancë dhe seanca përgatitore, në përbërje të plotë nga kryetari, së paku dy anëtarëve dhe sekretarit, ndërsa merr vendim me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

### Neni 3

Nëse në seancën përgatitore të Komisionit përcaktohet se kërkesa për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional nuk është në përputhje me nenet 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores për mënyrën e ushtrimit të vlerësimit (revizionit) profesional të projekteve minerare, Komisioni në afat prej shtatë ditëve i dorëzon njoftim kërkuarit në të cilin përcakton afatin në të cilin kërkuari do të duhet të ushtrojë plotësimin e kërkesës që nuk mund të jetë më e gjatë se 10 ditë nga dita e pranimin të njoftimit.

Nëse edhe pas afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, kërkuari nuk e dorëzon dokumentacionin e nevojshëm, kërkesa refuzohet nga Komision me aktvendim.

### Neni 4

Para mbajtjes së seancës së Komisionit, kryetari dhe anëtarët e Komisionit përpilojnë raport me shkrim lidhur me vlerësimin (revizionin) profesional të projektit minerar.

Në seancën e Komisionit marrin pjesë kryetari, anëtarët dhe sekretari i Komisionit, si dhe kërkuari dhe përpiluesi i projektit minerar.

Në seancën e Komisionit nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit, si dhe kërkuari dhe përpiluesi i projektit minerar shqyrtohet raporti me shkrim nga paragrafi 1 i këtij neni.

### Neni 5

Për rrjedhën e seancës së Komisionit përpilohet procesverbal, në të cilin në veçanti përmendet:

- data dhe vendi i mbajtjes së seancës së Komisionit;
- emri dhe mbiemri i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit, si dhe i përfaqësuesit të kërkuarit dhe përpiluesit të projektit minerar;
- përshkrim i shkurtër i rrjedhës së seancës së Komisionit dhe
- klauzolë revizioni dhe raport revizioni i Komisionit.

Procesverbalin nga paragrafi 1 i këtij neni e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e Komisionit, si dhe përfaqësuesi i kërkuarit dhe përpiluesi i projektit minerar.

Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 24-5415/1  
9.12.2022  
Shkup

Ministri i Ekonomisë,  
**Kreshnik Bekteshi**, d.v.